



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.120

1 shtator

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.635, datë 23.7.2010	Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2009”	5881
Vendim i KKRT nr.9, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Voskopi”.....	5899
Vendim i KKRT nr.10, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Krutja”.....	5900
Vendim i KKRT nr.11, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Cakrani”.....	5900
Vendim i KKRT nr.12, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Vjosa”.....	5901
Vendim i KKRT nr.13, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Belshi”.....	5901
Vendim i KKRT nr.14, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Bradsat”.....	5902
Vendim i KKRT nr.15, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Toshkëz”.....	5902
Vendim i KKRT nr.16, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Progres TV”.....	5903
Vendim i KKRT nr.17, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor M&G”.....	5903

Vendim i KKRT nr.18, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor DCT”	5904
Vendim i KKRT nr.19, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Pupa”	5904
Vendim i KKRT nr.20, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV Vlora Cable”	5905
Vendim i KKRT nr.21, datë 28.7.2010	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “TV kabllor Xhaçi”	5905
Vendim i KKRT nr.23, datë 28.7.2010	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus”	5906
Vendim i KKRT nr.24, datë 28.7.2010	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio Autostrada”	5906
Vendim i KKRT nr.25, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Val e Kaltër”	5907
Vendim i KKRT nr.26, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Top Gold”	5907
Vendim i KKRT nr.27, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Eurostar”	5908
Vendim i KKRT nr.28, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Fieri”	5908
Vendim i KKRT nr.29, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Club FM”	5909
Vendim i KKRT nr.30, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Rash”	5909
Vendim i KKRT nr.31, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Kukësi”	5910
Vendim i KKRT nr.32, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Energy”	5910
Vendim i KKRT nr.33, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Scan”	5911
Vendim i KKRT nr.34, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Kontakt”	5911
Vendim i KKRT nr.35, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Nesër TV”	5912
Vendim i KKRT nr.36, datë 28.7.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor radio “Nacional”	5912

VENDIM
Nr.635, datë 23.7.2010

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR “PËR NDIHMAT SHTETËRORE
TË VITIT 2009”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e” dhe 32, pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2009”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RAPORTI VJETOR PËR NDIHMAT SHTETËRORE TË VITIT 2009

KAPITULLI 1
1.HYRJE

Detyrimet ndërkombëtare për ndihmën shtetërore në Shqipëri, përfshirë kërkesat për transparencë dhe raportimin ndërkombëtar, burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian dhe shtetet anëtare, nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA) 2006, si dhe nga Marrëveshja për Subvencionet dhe Masat Kundërbalancuese (SCMA) në kuadër të OBT-së. Legjislacioni i ndihmës shtetërore (ligji dhe rregulloret në zbatim të tij) hyri në fuqi në janar 2006¹ periudhë prej së cilës vepron dhe sistemi kombëtar i ndihmës shtetërore për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e ndihmës shtetërore.

Në bazë të nenit 17 (dh) të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka detyrimin të hartojë raportin vjetor për ndihmat shtetërore dhe ta paraqesë atë pranë Këshillit të Ministrave, i cili, pasi e miraton, e përcjell në Komisionin Europian. Raporti për ndihmat shtetërore në Republikën e Shqipërisë, për vitin 2009 është përgatitur në përputhje me këto dispozita ligjore dhe kërkesat e MSA-së dhe CEFTA-s.

Në këtë raport janë reflektuar të dhëna dhe informacione të detajuara të ndihmës shtetërore lidhur me dhënësit, përfituesit dhe vlerën totale, me përjashtim të sektorit të peshkimit, i cili është jashtë fushës së zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore. Mbi bazën e raportimeve nga dhënësit e ndihmës, në këtë raport vërehet se ndryshimet më të rëndësishme i ka pësuar sektori i energjisë transportit publik, shërbimet publike, si dhe kërkim zhvillimi.

Shuma e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri gjatë viteve 2007-2009 është vlerësuar në rreth 35.429,77 milionë lekë (≈286 milionë €).

Ndihma shtetërore për vitin 2009, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 6.968,46 milionë lekë (52,75 milionë €), që përfaqësojnë 0.61 për qind të PBB-së të Republikës së Shqipërisë. Në të gjithashtu përfshihen të dhënat për ndihmën shtetërore për vitet 2007 dhe 2008 në mënyrë që të sigurohet krahasimi më mirë i vlerave të ndihmës të dhënë. Duhet të theksohet se pjesa më e madhe e skemave që japin ndihmë shtetërore nuk e tejkalon kufirin “De minimis” të BE-së

¹ Ligji nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar

dhe, si të tilla, përgjithësisht nuk paraqesin problem në këndvështrimin e tregtisë ndërkombëtare.

Hartimi dhe ndërmarrja e politikave makroekonomike në vitin 2009 e në vazhdim vazhdojnë të nxisin ritmin e rritjes ekonomike në vend në masën optimale, me qëllim lehtësimin sa më tepër të efekteve negative të krizës financiare globale.

Vlera e ndihmës së dhënë në vitin 2009 është vlerësuar të jetë efiçente si në periudhë afatshkurtër, ashtu dhe në atë afatgjatë, duke synuar mbajtjen në nivele të larta prodhimin, punësimin dhe mënjnauar shtrembërimin e konkurrencës.

1.2 METODOLOGJIA E RAPORTIMIT TË NDIHMËS SHTETËRORE

Në hartimin e raportit të tretë vjetor për ndihmat shtetërore, struktura e raportimit të ndihmës shtetërore është bazuar në aneksin III të rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, si dhe në metodologjinë e Komisionit Europian².

Në këtë raport, në mënyrë të ngjashme me atë të përdorur në të gjitha raportet e mëparshme, janë paraqitur të dhënat për kategoritë e mëposhtme të ndihmës shtetërore: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale), ndihma “Ad-hoc” dhe ndihma shtetërore për sektorin e bujqësisë.

Ndihma horizontale përfshin kategoritë që, kryesisht, synojnë të nxitin zhvillimin rajonal, kërkimin dhe zhvillimin, mbrojtjen e mjedisit dhe kursimin e energjisë, zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, punësimin, trajnimin dhe kulturën.

Ndihma sektoriale i referohet ndihmës shtetërore që jepet për sektorë të veçantë, duke përfshirë sektorin e transportit, shërbimet publike, transmetimet televizive, minierat dhe turizmin.

Ndihma Ad-hoc ose ndihma individuale është ndihma që projektohet për/dhe i jepet vetëm një ndërmarrjeje përfituese.

Ndihma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit të ndihmës shtetërore, gjë që është përcaktuar edhe në MSA³. Për periudhën tranzitore ajo raportohet apo shpjegohet nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore, siç rezulton në këtë raport (sipas klasifikimit të instrumenteve të ndihmës shtetërore në BE) janë:

- A1 - Subvencione dhe grante;
- A2- Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;
- B - Pjesëmarrja në kapital;
- C1 - Hua të buta;
- C2 - Të tjera instrumente;
- D - Garancitë.

Në llogaritjen e ekuivalentit të grantit të ndihmës për instrumentin A2 është përdorur norma referencë sipas metodologjisë së EU-së⁴ (e përdorur si normë skontimi), ndërsa për llogaritjen e ekuivalentit të ndihmës për skemën e garancisë është zbatuar metodologjia e përcaktuar në rregulloret për ndihmën shtetërore në formën e garancive.

Të dhënat e ndihmës shtetërore, të paraqitura në raportin vjetor për vitin 2008, janë rishikuar gjithashtu bazuar në të njëjtën metodologji të paraqitur më lart.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë raportuar nga dhënësit e ndihmës shtetërore, si: Ministria e Financave; Ministria e Punëve Publike dhe Transportit; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Albinvest.

² http://ec.europa.eu/comm/competition/state_aid/scoreboard/2006/autumn_en.pdf

³ Neni 71 pika 8 e MSA-së

⁴ Communication from the Commission on the revision of the method for setting the reference and discount rates (2008/C 14/02)

KAPITULLI 2

2. ZHVILLIMET KRYESORE RREGULLATORE DHE POLITIKE NË LIDHJE ME NDIHMËN SHTETËRORE NË SHQIPËRI NË 2009

2.1 SITUATA EKONOMIKE NË SHQIPËRI

Raportimi i ndihmave shtetërore të dhëna për vitin 2009 është mbështetur në një informacion krahasues të ecurisë të treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri. Zbatimi i reformave ekonomike në vend është shoqëruar me një rritje të ngadalësuar të ekonomisë për vitin 2009, e cila ka ardhur për shkak të krizës ekonomike në nivel botëror. Hartimi dhe ndërmarrja e politikave makroekonomike në vitin 2009 e në vazhdim vazhdojnë të nxisin ritmin e rritjes ekonomike në vend në masën optimale, me qëllim lehtësimin sa më tepër të efekteve negative të krizës financiare globale.

Vlera e ndihmës së dhënë në vitin 2009 është vlerësuar të jetë efiçente si në periudhë afatshkurtër, ashtu dhe në atë afatgjatë, duke synuar mbajtjen në nivele të larta prodhimit, punësimin dhe mënjanimin e shtrembërimit të konkurrencës. Tabela 1 pasqyron zhvillimet në sektorin fiskal, monetar dhe atë të punës për periudhën 2006-2009.

Ekonomia botërore gjatë vitit 2009 u karakterizua nga një tkurrje e aktivitetit ekonomik. Integrimi në rritje i ekonomisë shqiptare dhe veçanërisht i sistemit tonë financiar bëri që kriza botërore të reflektonte në Shqipëri duke dhënë ndikim të shpejtë në aktivitetin ekonomik në vend (reduktim të hyrjeve valutore në llogarinë korrente dhe kapitale, me një ulje të menjëhershme të kërkesës së jashtme dhe me një ngadalësim të kërkesës së brendshme për mallra e shërbime). Ky ndikim mori formën e uljes së normave të rritjes dhe të lëkundjes së disa ekuilibrave makroekonomikë gjatë vitit 2009. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, ritmi i rritjes ekonomike shënoi një ngadalësim progresiv gjatë vitit të shkuar, por duke mbetur gjithsesi në territor pozitiv në vlerën 3.3 %.

Ngadalësimi i ekonomisë vendase ndikoi ecurinë e politikës fiskale dhe të treguesve fiskalë. Politika fiskale pati një natyrë stimuluese, e cila u reflektua në zgjerimin e deficitit buxhetor. Deficiti buxhetor për vitin 2009 vlerësohet të jetë rreth 7 për qind e produktit të brendshëm bruto. Zgjerimi i deficitit buxhetor ndikoi në rritjen e borxhit publik, i cili në fund të vitit 2009 vlerësohet në rreth 59.5 për qind e prodhimit të brendshëm bruto.

Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit rezultoi brenda objektivit të BSH-së prej 3 ± 1 % gjatë vitit 2009. Inflacioni vjetor shfaqti prirje rritëse në tremujorin e katërt, duke shënuar 2.9 për qind në terma mesatarë⁵. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe presionet e ulëta inflacioniste nga ekonomia botërore, krijuan një ambient me presione relativisht të dobëta inflacioniste.

Treguesit kryesorë ekonomikë në periudhën 2006 - 2009 janë treguar në tabelën 1 më poshtë.

⁵ **INSTAT:** Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit në % 2009 – 2010

Tabela 1 Treguesit ekonomikë për periudhën 2006-2009

Treguesit makro-ekonomik	2006	2007	2008	2009
Rritja reale e PBB (në %)	5.4	6.0	7.8	3.3
PBB (me çmimet korrente, në milionë LEK)	882,209	967,670	1,088,132	1,143,373
PBB (në milion Euro)	7,243.00	8,014.00	8,843.00	8,655.36
Popullsia (në milion banorë)	3.15	3.16	3.17	3.19
PBB (për frymë në Euro)	2,277	2,479	2,791	2,728
Numri i të punësuarve (në mijë)	935	966	970	972
Përqindja e papunësisë	13.80	13.50	13.20	13.75
Norma e inflacionit	2.4	2.9	3.4	3.5
Deficiti Buxhetor (në % ndaj PBB)	-3.30	-3.50	-5.50	-7.00
Borxhi publik (në % ndaj PBB)	56.10	53.20	54.90	59.50
Borxhi i jashtëm (në % ndaj PBB)	16.50	15.20	18.00	23.10
Llogaria korrente (në % ndaj PBB)	-6.6	-10.6	-14.9	-15.6
Kursi mesatar i këmbimit, LEK/EURO	123.08	121.78	123.80	132.10

Ngadalësimi i rritjes së produktit të brendshëm bruto ka reflektuar kontraktimin e aktivitetit në sektorët e industrisë dhe të ndërtimit, ndërkohë që vlera e shtuar nga sektori i shërbimeve mbeti kontribuesi kryesor në rritjen ekonomike. Perspektiva e zhvillimit ekonomik të vendit kërkon, gjithashtu, një mbështetje më të madhe në sektorin privat, ndërkohë që ndikimi i sektorit publik në rritjen ekonomike pritet të vijë në rënie⁶.

Në këtë kontekst, aktualisht, drejtimet strategjike të qeverisë shqiptare, lidhur me zhvillimin e biznesit janë të fokusuara në krijimin e një partneriteti të qëndrueshëm shtet-biznes dhe të një klime nxitëse për zbatimin e politikave të investimeve dhe eksportit nëpërmjet industrializimit dhe orientimit të investimeve në degë me teknologji të lartë.

Këto drejtime edhe për periudhën në vazhdim do të synojnë një rritje ekonomike të qëndrueshme, produktivitet dhe konkurrueshmëri më të lartë, nëpërmjet zhvillimit dinamik të ndërmarrjeve, nxitjes së investimeve, shfrytëzimit më të mirë të kapitalit njerëzor dhe asaj financiare⁷. Të gjitha këto mbeten sfida të zhvillimit të ekonomisë shqiptare të cilat do të ndikojnë në sjelljen organizative të ndërmarrjeve për të shpenzuar më shumë burime të ardhurash në teknologji, makineri e pajisje me qëllim gjenerimin e numrit të vendeve të reja të punës.

2.2 DETYRIMET NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME NDIHMËN SHTETËRORE⁸

Detyrimet e Shqipërisë për një sistem rregullator transparent lidhur me ndihmat shtetërore dhe subvencionet (duke përfshirë edhe raportimet) rrjedhin nga MSA-ja⁹, vendimi i Partneritetit

⁶ Fjala e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani, në prezantimin e raportit vjetor për vitin 2009 në Kuvendin e Shqipërisë, 29 prill 2010

⁷ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 11.7.2007 "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve për periudhën 2007-2013".

⁸ Për detaje të mëtejshme të shihet kapitulli 3 i raportit vjetor të ndihmave shtetërore të vitit 2007.

⁹ Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit midis Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare, nga njëra anë dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, nënshkruar në 12 qershor 2006.

European i nëntorit 2007¹⁰, Marrëveshja e OBT-së “Për subvencionet dhe masat kundërbalancuese”¹¹, si dhe Marrëveshja e CEFTA-s (2006)¹².

Megjithëse detyrimet ndërkombëtare kanë nxitur Shqipërinë për të përshtatur subvencionimin dhe ndihmat shtetërore me normat dhe praktikat ndërkombëtare, arsyeimi për futjen e këtij sistemi ka një dimension kombëtar që është tejet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe thuajse i pavarur nga faktorët e jashtëm. Në mënyrë të veçantë, ndihmat shtetërore dhe subvencionet në Shqipëri po shihen gjithnjë e më shumë si lehtësim i shpenzimeve të burimeve të pakta buxhetore, për të realizuar në mënyrë efikente programet e zhvillimit brenda vendit dhe për të shmangur shpërdorimin e fondeve publike

Më 1 prill 2009 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim- Asocimit, ndërkohë që është shfuqizuar Marrëveshja e Përkohshme (INTERIM), e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 2006. Detyrimet e Marrëveshjes së Përkohshme, në fushën e veprimit të së cilës hynte edhe ndihma shtetërore, do të jenë tashmë pjese përbërëse e MSA-së. Rrjedhimisht MSA përbën bazën ligjore të ndihmës shtetërore tek e cila mund të bëhet referim i drejtpërdrejtë.

Në drejtim të raportimit, MSA kërkon raportim të rregullt reciprok, pra kërkon transparencë ndërkombëtare në lidhje me të gjitha masat e marra nga autoritetet administrative në nivel lokal dhe qendror, si dhe nga institucionet e tjera që veprojnë në emër të shtetit, lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore. Ndërsa në BE tashmë funksionon një mekanizëm raportues i detajuar/ transparent vjetor për ndihmat shtetërore, në Shqipëri kjo ka filluar në vitin 2008.

Raporti vjetor i ndihmave shtetërore për vitin 2007¹³ është në përputhje me këto detyrime. Edhe në sistemin e OBT-së, është standard përgatitja e raporteve të detajuara për subvencionet industriale, kërkesë, të cilën Shqipëria e plotësoi në mars 2008.

Vendimi i Partneritetit European në shkurt 2008¹⁴ thekson, ndër të tjera, rëndësinë e zbatimit të legjislacionit për ndihmën shtetërore dhe përditësimin e vazhdueshëm të inventarit të skemave të ndihmës shtetërore. Në një periudhë afatmesme, vendimi i Partneritetit European kërkon t'i jepet përparësi zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kontrollit të ndihmës shtetërore dhe përfundimin e alinjimit të skemave të ndihmës shtetërore me rregullat e BE-së. Prioritetet afatshkurtra të PE priten të realizohen deri në fillim të 2010 dhe prioritetet afatmesme deri në fillim të 2012. Vazhdimi i zbatimit të sistem rregullator të ndihmës shtetërore dhe zgjerimi i mëtejshëm i saj në vitin 2008 është realizuar në përputhje me këto udhëzime.

2.3 ZHVILLIMET KRYESORE LIGJORE DHE POLITIKE NË LIDHJE ME NDIHMËN SHTETËRORE NË VITIN 2009

NDRYSHIMET LIGJORE

Në kuadër të procesit të integritetit dhe detyrimeve për përafrimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit European kuadri ligjor ekzistues është plotësuar me miratimin e ligjit nr. 10 183, datë 29.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore””. Ndryshimet dhe shtesat që i janë bërë këtij ligji, reflektojnë ndryshimet përkatëse në legjislacionin european për fushën e ndihmës shtetërore, si rezultat i reformës ligjore e ndërmarrë gjatë viteve 2005-2008. Ato konsistojnë në ndryshimin e intensitetit të ndihmës për kategori të ndihmave shtetërore si ndihma për trajnim, ndihma për punonjësit në vështirësi dhe me aftësi të

¹⁰ Vendimi i Këshillit European mbi parimet, prioritetet dhe kushtet e Partneritetit European me Shqipërinë dhe shfuqizimin e vendimit 2006/54/EC, COM (2007) 656 përfunduar 6 nëntor 2007.

¹¹ Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese, 1994, Sekretariati GATTS (1994) Rezultatet e Raundit të Uruguait për negociata tregtare shumëpalëshe, teksti ligjor, Gjenevë, “Marrëveshja për subvencionet dhe masat kundërbalancuese”, pp. 264-314.

¹² Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (2006) Marrëveshja për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA), <http://www.stabilitypact.org/WT2/TradeCEFTA2006.asp>

¹³ Miratuar me vendim të Këshillit të i Ministrave nr. 1023, datë 9.07.2008 dhe dërguar në Komisionin European dhe CEFTA.

¹⁴ Vendimi i Këshillit European 2008/210/EC 18 shkurt 2008 mbi parimet, prioritetet dhe kushtet e Partneritetit European me Shqipërinë.

kufizuar duke i rritur vlerat respektive deri në kufijtë e përcaktuar në rregulloren 800/2008 të BE-së. Në ligjin e ri janë parashikuar, gjithmonë në përputhje me rregullat e vendosura nga Komisioni Europian, edhe tre kategori të reja ndihme që janë:

Ndihma për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara, e cila jepet për ndërmarrjet e vogla, kur ato janë në fazat e para të themelimit, ngritjes e zhvillimit të tyre. Kjo ndihmë krijon mundësinë e mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla të sapokrijuara deri në 200 000 euro për përballimin e kostove administrative, ligjore dhe këshillimore, që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e tyre, si dhe për kostot operacionale për 5 (pesë) vitet e para pas krijimit të ndërmarrjes. TVSH-ja dhe tatimi mbi të ardhurat e biznesit nuk përfshihen në kostot e pranueshme.

Ndihma për mbrojtjen e mjedisit do të shërbejë si bazë për hartimin e atyre skemave të ndihmës, që kanë për qëllim ndreqjen apo parandalimin e dëmtimeve të mjedisit, burimeve natyrore, si dhe nxitjen e përdorimit sa më eficient të këtyre burimeve. Kontrolli i ndihmës shtetërore në këtë fushë do të garantojë kryerjen e investimeve që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit në një nivel më të lartë, duke mundësuar që efektet pozitive të investimit të tejkalojnë ato negative që vijnë nga përdorimi i ndihmës. Edhe këtu ka bonuse të veçanta për intensitetin e ndihmës për ndërmarrjet e mesme dhe ato të vogla.

Ndihma në formën e riskut të kapitalit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, parashikon kushtet, në të cilat mund të lejohen skemat e ndihmës në formën e riskut të kapitalit për SME-të. Skemat e riskut të kapitalit për SME-të, që marrin formën e burimeve të investimit, në të cilën një pjesë e konsiderueshme e burimeve duhet të vijnë si kapital privat, si dhe forma e ndërhyrjes me anë të aksioneve ose obligacione të konvertueshme, mund të jenë të lejueshme vetëm nëse përdoren në ofrimin e kapitalit bazë, kapitalit themeltar dhe/ose për zgjerimin e kapitalit të SME-ve.

Norma e interesit

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, bazuar në nenin 15 të rregullores “ Për procedurat dhe formën e njoftimit” (miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005) me vendim ka miratuar normën e interesit për kthimin e ndihmës shtetërore. Norma e përcaktuar në masën 8,74 % do të aplikohet për kthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme për vitin 2009.

Harta e ndihmës shtetërore

Në kuadër të MSA-së Shqipëria duhet të përgatisë hartën rajonale për ndihmën shtetërore dhe të paraqesë pranë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas shërbimet e komisionit dhe strukturat e kontrollit të ndihmës shtetërore duhet të shqyrtojnë së bashku përputhshmërinë e rajoneve dhe intensiteteve maksimale të ndihmës që lidhen me to, me qëllim përgatitjen e hartës rajonale për ndihmën shtetërore, mbi bazën e udhëzimeve përkatëse të komisionit.

Konkretisht neni 71, pika 7 paragrafi b i MSA-së përcakton:

Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Europiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4¹⁵ dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë, si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

Duke qenë se Shqipëria nuk ka një klasifikim statistikor apo rajonal në nivelin NUTS II, si dhe në mungesë të treguesve të PBB-së ndarë në nivel qarku (aktualisht në Shqipëri janë 12 qarqe), gjatë vitit 2008 ka filluar punën për përgatitjen e kësaj harte. Në periudhën e parë tranzitore është parashikuar përgatitja e një harte dhe përcaktimi i zonave më të prapambetura, që mund të përfitojnë ndihmë shtetërore me një intensitet më të lartë se pjesët e tjera të vendit. Analiza është kryer në nivel qarku bazuar në treguesit e disponueshëm statistikorë, të marrë zyrtarisht nga INSTAT për vitet 2006-2007. Në mungesë të treguesve të PBB-së, janë përdorur tregues të tjerë për analizë, si ai

¹⁵ Autoriteti për kontrollin e ndihmës shtetërore në Republikën e Shqipërisë

i nivelit të papunësisë, nivelit të varfërisë, aksesit në shërbimet bazë, si dhe është bërë vlerësimi krahasues, duke analizuar edhe treguesin e dendësisë së popullsisë sipas qarqeve. Harta e ndihmës shtetërore është miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në vendimin e tij nr. 30, datë 8.04.2008, harta është përgatitur me mbështetjen e ekspertëve të projektit CARDS 2005.

Zbatimi i legjislacionit

Në zbatim të procedurave ligjore, KNSH ka shqyrtuar dhe vlerësuar planin e ndihmës shtetërore dhe ka marrë vendimin nr. 31, datë 6. 05. 2009 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për shpalljen e zonës ekonomike me statusin e zonës së lirë, Vlorë”” .

Shkurtimisht rasti mund të përmbledhet si më poshtë:

Plani për dhënien e ndihmës ka si objektiv kryesor zhvillimin rajonal, i cili synohet të arrihet përmes kryerjes së investimeve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, të lidhura me këto investime. KNSH vendosi që:

- nga ky plan ndihme do të përfitojnë të gjitha ndërmarrjet që do të ushtrojnë veprimtaritë sipas pikës 3 të projektvendimit të Këshillit të Ministrave dhe që nuk janë ndërmarrje në vështirësi.

- Kontributi i përfituesit/përfituesve për financimin e investimit fillestar duhet të jetë të paktën 25%.

- Në çdo rast ndihma për ndërmarrjet përfituese do të jetë e lejueshme nëse lidhet me një projekt investimi fillestar dhe krijimin e vendeve të reja të punës, në bazë të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”.

- Intensiteti i ndihmës për ndërmarrjet e mëdha nuk duhet të kalojë 50%. Ky kufi mund të rritet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të vendosura në zonë, me 15% të vlerës bruto. Përveç kostove të pranueshme, të lidhura me investimin dhe të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, në llogaritjen e intensitetit do të merren parasysh të gjitha përjashtimet apo lehtësimet nga taksat, si dhe të gjitha format e tjera të ndihmës. Nuk lejohet përshtimi i ndihmës që tejkalon maksimumin e lejuar të intensitetit, për të njëjtat kosto të pranueshme.

KAPITULLI 3

3.1 NDIHMA SHTETËRORE PËR 2009

VËSHTRIM MBI NDIHMËN SHTETËRORE NË SHQIPËRI NË PERIUdhËN 2007-2009

Ndihma shtetërore për vitin 2009 në Republikën e Shqipërisë arriti në vlerën 6.968,46 milionë lekë. Kjo vlerë e ndihmës është 56 % më pak në krahasim me vitin 2007. Treguesi i ndihmës shtetërore kundrejt GDP për vitin 2009, ka pësuar një ulje i cili është 0.61 për qind në krahasim me 2008, ku llogaritet në 1.16 për qind.

Në vitin 2009 ndihma shtetërore për çdo punonjës llogaritet në vlerën 7169 lekë, e cila është në rënie prej 58 për qind në krahasim me 2007, kur ndihma për çdo punonjës ishte në vlerën 16.965 lekë. Ndihma shtetërore për frymë gjithashtu shënon një rënie nga 5.017 lekë për vitin 2007, në 2184 lekë për vitin 2009, në një reduktim prej 56 për qind.

Tabela 3 Ndhimja shtetërore në Shqipëri për vitet 2007-2009 përfshirë bujqësinë dhe peshkimin

Emërtimi	Njësia e matjes				Indekset		
		2007	2008	2009	2007	2008/ 2007	2009/ 2007
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		121,78	122,80	132,10			
Ndhimja shtetërore	million LEK	15.862,54	12.598,76	6.968,46	100%	79%	44%
Ndhimja shtetërore	million Euro	130,26	102,60	52,75	100%	79%	40%
PPB nominal	miliard LEK	956.314	1.086.000	1.143.373	100%	114%	120%
PPB nominal	million Euro	7.885,00	8.843,00	8.655,36	100%	112%	110%
Ndhimja shtetërore në raport ndaj PPB	%	1,65%	1,16%	0,61%	100%	70%	37%
Shpenzimet gjithsej	miliard LEK	285.329	350.270	384.800	100%	123%	135%
Shpenzimet gjithsej	million Euro	2.342,99	2.852,36	2.912,94	100%	122%	124%
Ndhimja shtetërore në raport ndaj shpenzimeve gjithsej	%	5,56%	3,60%	1,81%	100%	65%	33%
Numri i të punësuarve	million	0,935	0,970	0,972	100%	104%	104%
Ndhimja shtetërore për çdo punonjës	LEK	16.965	12.988	7.169	100%	77%	42%
Ndhimja shtetërore për çdo punonjës	Euro	139	106	54	100%	76%	39%
Numri i të papunëve	million	0,143	0,154	0,145	100%	108%	101%
Ndhimja shtetërore për çdo të papunë	LEK	111.027	81.974	48.138	100%	74%	43%
Ndhimja shtetërore për çdo të papunë	Euro	912	668	364	100%	73%	40%
Popullsia	million	3,16	3,17	3,19	100%	100%	101%
Ndhimja shtetërore për frymë	LEK	5.017	3.974	2.184	100%	79%	44%
Ndhimja shtetërore për frymë	Euro	29	32	17	100%	112%	57%

Ulja e vlerës së ndihmës totale për vitin 2009, në krahasim me vitin 2008, në shumën prej 5, 630.3 milionë lekë ka ardhur për shkak të një reduktimi të ndjeshëm të ndihmës për: energjinë, shërbimet publike, kërkim dhe zhvillimin dhe transportin publik. Gjithashtu, më pak ndihmë është dhënë për ndihmat operacionale, punësimin, trajnimin dhe minierat.

Në grafikun 1 paraqitet ecuria e treguesit të raportit të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së për vitet 2005-2009. Pas një ulje të ndihmës shtetërore ndaj PBB-së nga viti 2007 deri në vitin 2008, në vitin 2009 ndihma shtetërore ndaj PBB-së pëson një rënie të ndjeshme, saktësisht, nga 1.65 për qind në 0.61 për qind. Vlera maksimale e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së siç vërehet në grafik, për vitin 2007 ka ardhur si pasojë e subvencionimit të drejtpërdrejtë të KESH sh.a., si edhe ndihmën për konsumatorët individualë¹⁶.

¹⁶ Raporti vjetor 2007

Grafiku 1 Ndihma shtetërore në raport ndaj PBB për periudhën 2005 – 2009



Referuar metodologjisë së BE-së, ku ndihma shtetërore për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit monitorohen dhe vlerësohen secila më vete, në tabelën 4, paraqiten të dhënat e ndihmës shtetërore në Shqipëri, për 3 vitet e fundit, duke përjashtuar vlerën e dhënë për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit. Vlera e ndihmës shtetërore në vitin 2009 është 5,415.92 milionë lekë, duke përjashtuar sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit.

Pjesa që zë ndihma shtetërore (pa përfshirë sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe transportit) në raport me PBB-në përdoret nga BE për të bërë krahasimet midis shteteve, si dhe për të monitoruar prirjen e vlerës totale të ndihmës shtetërore. Nivelet e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së nga 0,9 % për vitin 2007 arrin në 1 % për vitin 2008, ndërsa në vitin 2009 në 0,47 %.

Tabela 4 Ndihma shtetërore në Shqipëri për vitet 2007-2009 (përjashtuar bujqësinë, peshkimin, ndihmën individuale dhe transportin)

Emërtimi	Njësia e matjes	2007	2008	2009
Ndihma shtetërore totale	million LEK	8.855,86	10.925,00	5.415,92
Ndihma shtetërore	million Euro	72,72	88,97	41,00
PPB Nominal	miliard LEK	956.314	1.086.000	1.143.373
PPB Nominal	million Euro	7.885	8.843	8.655
Ndihma shtetërore ndaj PPB	%	0,922	1,006	0,474

Mesatarja e raportit ndihmë shtetërore ndaj PBB-së për vendet e BE-së (pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin) siç paraqitet edhe në tabelën 5, është në vlerat 0,4 % për vitet 2007 dhe 2008¹⁷.

Tabela 5 Ndhimja shtetërore në Shqipëri në total krahasuar me mesataren në BE për vitet 2007-2008

Emri i shteteve	2007		2008	
	mIn Euro	Ndhimja shtetërore/PPB	mIn Euro	Ndhimja shtetërore/PPB
Shqipëria	72,72	0,92	88,97	1,01
EU27	51102,1	0,39	265048,1	0,42
EU15	47026,7	0,38	256946,6	0,40
EU12	4075,5	0,44	8101,5	0,72
Belgjika	1088,8	0,32	19008,6	0,36
Bullgaria	30,1	0,09	39,3	0,12
Çekia	811,6	0,63	1158,2	0,78
Danimarka	1603,4	0,68	4507,5	0,71
Gjermania	14109,4	0,56	65315,4	0,57
Estonia	11,2	0,07	14,5	0,09
Irlanda	593,8	0,31	36273,8	0,38
Greqia	585,1	0,25	810,8	0,33
Spanja	3889,9	0,36	5305,4	0,40
Franca	7253,1	0,37	24079,6	0,39
Italia	4119,0	0,26	4487,8	0,29
Qipro	66,7	0,41	79,7	0,47
Letoni	48,9	0,20	1010,6	0,20
Lituani	49,6	0,16	170,9	0,53
Luksemburg	47,2	0,13	2853,8	0,15
Hungaria	912,8	0,87	1915,1	1,81
Malta	112,1	2,00	100,0	1,74
Hollanda	1381,8	0,24	15590,8	0,25
Austria	892,5	0,32	1069,7	0,38
Polonia	1365,9	0,43	2908,0	0,80
Portugalia	2159,9	1,30	1959,8	0,92
Rumania	310,2	0,22	252,4	0,18
Sllovenia	125,3	0,35	173,0	0,47
Sllovakia	231,0	0,36	279,7	0,42
Finlanda	634,6	0,34	814,9	0,44
Suedia	2902,0	0,85	3072,3	0,82
Anglia	5766,4	0,20	71796,5	0,17

Vlera e ndihmës ndaj PBB-së për vitet 2007-2008 për Shqipërinë nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme (nga 0.92 për vitin 2007 në 1.01 për vitin 2008). Për vendet e EU-së rritja është gjithashtu e lehtë, duke pasur parasysh se në këtë krahasim nuk përfshihet ndihma shtetërore e dhënë nga shtetet anëtare në kuadrin e krizës ekonomike-financiare.

3.2 KATEGORITË E NDIHMËS SHTETËRORE


Në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, përveç uljes prej 5,630.3 milionë lekë në shumën e ndihmës shtetërore totale, kanë ndodhur edhe ndryshime të dukshme në kategoritë kryesore të ndihmës për ekonominë shqiptare.

Tabela 6 Klasifikimi sipas kategorive i ndihmës shtetërore në Shqipëri, për vitet 2007-2009 (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin)

Kategoria e ndihmës	2007			2008			2009		
	mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)	mln LEK	mln EUR	(%)
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>	121,78			122,80			132,10		
A Ndhimat horizontale	3.482,15	28,59	21,95	5.292,80	43,10	42,01	4.333,89	32,81	62,19
1 Ndhima rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2 Punësimi	77,60	0,64	0,49	80,20	0,65	0,64	72,43	0,55	1,04
3 Kultura	121,07	0,99	0,76	-	-	-	-	-	-
4 Mjedis	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5 Eksporti	-	-	-	0,42	0,0035	0,0034	0,15	0,0011	0,0022
6 Ndhima operacionale	66,74	0,55	0,42	2.989,72	24,35	23,73	2.477,51	18,75	35,55
7 Shpëtimi dhe rristurimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8 Kërkimi dhe Zhvillimi	1.126,14	9,25	7,10	2.078,65	16,93	16,50	1.645,90	12,46	23,62
9 SME-të	2,40	0,02	0,02	12,80	0,10	0,10	21,00	0,16	0,30
10 Sporti	48,61	0,40	0,31	-	-	-	-	-	-
11 Trainimi	39,60	0,33	0,25	131,00	1,07	1,04	116,91	0,88	1,68
12 Ndhima sociale për konsumatorë individualë	2.000,00	16,42	12,608	-	-	-	-	-	-
B Ndhima sektoriale (vertikale)	6.108,21	50,16	38,51	6.369,97	51,87	50,56	1.595,74	12,08	22,90
12 Transporti publik	734,50	6,03	4,630	737,77	6,01	5,86	513,71	3,89	7,37
13 Shërbimet publike	1.619,13	13,30	10,207	1.454,38	11,84	11,54	878,00	6,65	12,60
14 Minierat	-	-	-	56,92	0,46	0,45	43,27	0,33	0,62
15 Energjia	3.732,82	30,65	23,532	4.118,01	33,53	32,69	157,86	1,20	2,27
16 Audio-Vidio	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17 Televizionet/mediat	2,86	0,02	0,018	2,89	0,02	0,02	2,89	0,02	0,04
19 Turizmi	18,90	0,16	0,119	-	-	-	-	-	-
C Ndhima Individuale	5.000,00	41,06	31,521	-	-	-	-	-	-
D Bujqësia	1.272,18	10,45	8,020	936,00	7,62	7,43	1.038,83	7,86	14,91
TOTALI	15.862,54	130,26	100	12.598,76	102,60	100,00	6.968,46	52,75	100,00

Më konkretisht, në këtë vit tendencë në rënie kanë pësuar kategoritë e ndihmave horizontale dhe vertikale (sektoriale). Në vitin 2009 ndihma horizontale është ulur me 958.91 milionë lekë në krahasim me vitin 2008, ose me 17.3 për qind. Në të njëjtën kohë, kategoria e ndihmës vertikale (sektoriale) është zvogëluar në 4,774.23 milionë lekë, ose me 84.8 për qind.

Grafiku 2 Ndhima shtetërore për vitin 2009 ndaj 2008 në %



Sikurse vërehet edhe në grafikun 2, uljen më të madhe në kategorinë horizontale në vitin 2009, në krahasim me 2008, shënohet nga ndihma operationale me 9.1 për qind, ndaj ndryshimit të vlerës totale të ndihmës (përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin), duke u pasuar nga ndihma për kërkim dhe zhvillim, me 7.69 për qind, ndihma për trajnim me 0.25 për qind dhe ndihma për punësimin me 0.14 për qind. Në kategorinë e ndihmave vertikale (sektoriale), rënien më të madhe e shënon ndihma për energjinë me 70.34 për qind, e pasuar nga ndihma për shërbimet publike me 10.24 për qind, ndihmën për transportin publik me 3.98 për qind dhe ndihmën për minierat me 0.24 për qind.

Ndërsa tabela 7 paraqet ndihmat e dhëna në Shqipëri, gjatë së njëjtës periudhë, por duke përjashtuar ndihmën shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin.

Tabela 7 Klasifikimi sipas kategorive i ndihmës shtetërore për vitet 2006-2008 (përjashtuar bujqësinë dhe peshkimin)

Kategoria e ndihmës	2007			2008			2009		
	mIn LEK	mIn EUR	(%)	mIn LEK	mIn EUR	(%)	mIn LEK	mIn EUR	(%)
kursi mesatar i këmbimit	121.78			122.80			132.10		
A Ndihamat horizontale	3.482,15	28,59	23,87	5.292,80	43,10	45,38	4.333,89	32,81	73,09
1 Ndihamat rajonale	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2 Punësimi	77,60	0,64	0,53	80,20	0,65	0,69	72,43	0,55	1,22
3 Kultura	121,07	0,99	0,83	-	-	-	-	-	-
4 Mjedis i	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5 Eksporti	-	-	-	0,42	0,0035	0,0036	0,15	0,0011	0,0025
6 Ndihamat operationale	66,74	0,55	0,46	2.989,72	24,35	25,63	2.477,51	18,75	41,78
7 Shpëtimi dhe rristurimi	-	-	-	-	-	-	-	-	-
8 Kërkim i dhe Zhvillim i	1.126,14	9,25	7,72	2.078,65	16,93	17,82	1.645,90	12,46	27,76
9 SME-të	2,40	0,02	0,02	12,80	0,10	0,11	21,00	0,16	0,35
10 Sporti	48,61	0,40	0,33	-	-	-	-	-	-
11 Trainimi	39,60	0,33	0,27	131,00	1,07	1,12	116,91	0,88	1,97
12 Ndihamat sociale për konsumatorë individualë	2.000,00	16,42	13,708	-	-	-	-	-	-
B Sectoral (vertical) aid	6.108,21	50,16	41,86	6.369,97	51,87	54,62	1.595,74	12,08	26,91
12 Transporti publik	734,50	6,03	5,034	737,77	6,01	6,33	513,71	3,89	8,66
13 Shërbimet publike	1.619,13	13,30	11,097	1.454,38	11,84	12,47	878,00	6,65	14,81
14 Minierat	-	-	-	56,92	0,46	0,49	43,27	0,33	0,73
15 Energjia	3.732,82	30,65	25,584	4.118,01	33,53	35,31	157,86	1,20	2,66
16 Audio-Vidio	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17 Televizionet/mediat	2,86	0,02	0,020	2,89	0,02	0,02	2,89	0,02	0,05
19 Turizmi	18,90	0,16	0,130	-	-	-	-	-	-
C Ndihamat Individuale	5.000,00	41,06	34,269	-	-	-	-	-	-
TOTAL	14.590,36	119,81	100	11.662,77	94,97	100	5.929,63	44,89	100

3.3 INSTRUMENTET E NDIHMËS SHTETËRORE

Duke ndjekur metodologjinë e BE-së për raportimin e ndihmës shtetërore, në këtë raport janë paraqitur të dhënat për kategoritë e ndihmës shtetërore, të tilla si: ndihma horizontale, ndihma sektoriale (vertikale) dhe ndihma “Ad-hoc”.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënie e ndihmës shtetërore, siç rezulton në këto raporte, kanë qenë grantet, përjashtimi dhe ulja e taksave (sipas klasifikimit të instrumenteve të ndihmës shtetërore në BE):

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Të tjera instrumente;

D – Garancitë.

Tabela 8 Ndhimja shtetërore në Shqipëri e klasifikuar sipas instrumenteve

Kategoria e Instrumenteve	Instrumentat e Ndhimës Shtetërore	Treguesit	2007	2008	2009
A1	Subvencione dhe Grante	%	66,22	21,20	27,75
		lek	9.661,81	2.473,07	1.645,32
		eur	79,34	20,14	12,46
A2	Përrjashtim nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale	%	33,76	78,77	72,20
		lek	4.925,70	9.186,38	4.281,27
		eur	40,45	74,81	32,41
B	Pjesmarrje në kapital	%	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C1	Hua të buta	%	-	-	-
		lek	-	-	-
		eur	-	-	-
C2	Të tjera instrumente	%	0,02	0,025	0,05
		lek	2,86	2,89	2,89
		eur	0,02	0,02	0,02
D	Garancitë	%	-	0,004	0,00253
		lek	-	0,42	0,15
		eur	-	0,003	0,0011

Instrumentet që zënë peshën më të madhe në vitin 2009 janë përrjashtimet, shtyrja, ulja e normës së taksave dhe zbritja e kontributit në sigurimet sociale (A2) me 72.2 për qind, me një vlerë prej 4,281.27 milionë lekë, ndjekur nga subvencionet dhe grantet (A1) me 27.75 për qind ose në vlerën prej 1,645.32 milionë lekë, ndërsa instrumentet e tjera (C2) dhe garancitë (D) kanë qenë përkatësisht në 0.05 për qind dhe 0.0025 për qind.

Në instrumentin e “Përrjashtimi nga taksat dhe shtyrja e taksave” (A2), në vitin 2009 vërehet se ndihmat operacionale zënë një peshë prej 58 për qind, kërkim-zhvillimi 38 për qind dhe sektori i energjisë 4 për qind.

Në ndihmat operacionale përfshihen: skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.¹⁸, skema për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit¹⁹ dhe skema për përrjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW²⁰.

Në instrumentin A1 i cili ka një vlerë prej 1,645.32 milionë lekë janë përfshirë të gjitha subvencionet e dhëna në bazë të ligjit nr. 10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”.

Instrumenti i garancisë shtetërore (D) ka pasur një rënie në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008. Në këtë instrument përfshihet skema e “Fondit të Garantimit të Kredive të Eksportit”²¹, të miratuar nga KNSH në vendimin e tij nr. 16, datë 16.07.2007. Vlera e ndihmës së dhënë financon

¹⁸ Vendimi i KNSH nr. 17 , datë 16.07.2007 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSh-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”

¹⁹ Vendimi i KNSH-së nr. 24, datë 2.05.2008 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit” .

²⁰ Vendim i KNSH-së nr. 25 , datë 2. 05. 2008 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përrjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW”, i ndryshuar me vendimin nr. 27, datë 18.08.2008 të KNSH-së.

²¹ Vendim i KNSH-së nr.16, datë 16.07.2007 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për fondin e garantimit të kredive të eksportit”” .

kërkesat për kolateral për kredi tregtare të kërkuar nga bankat duke rritur shkallën e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare. Fondi lëshon garanci për eksportuesit, kur ata kanë nevojë për financime afatshkurtra, për të përfunduar marrëveshjet me blerësit e huaj.

Në llogaritjen e ekuivalentit të ndihmës për garancitë është zbatuar metodologjia e përcaktuar në rregulloret për ndihmën shtetërore në formën e garancive. Për vitin 2009 shuma totale e garancisë është 23.6 milionë lekë (duke u vlerësuar me një normë të primit të garancisë rreth 2 % dhe normë të riskut për kreditë rreth 3.6 - 5 %).

3.4 NDIHMA HORIZONTALE

Ndihmat horizontale në vitin 2009 kanë pasur një trend në ulje me 958.31 milionë lekë kundrejt vitit 2008; kjo ka ardhur si pasojë e një uljeje të ndihmave për kategoritë, si: punësimi, kërkim dhe zhvillimi, operacionale, garancitë për eksport dhe trajnimi.


Në strukturën e ndihmës horizontale për vitin 2009, peshën më të madhe e zë ndihma operacionale me 57 për qind, duke u ndjekur nga ndihma për kërkim dhe zhvillim me 38 për qind, nga ndihma për trajnim me 3 për qind dhe më pas nga ndihma për punësimin me 2 për qind.

Tabela 9 Shpërndarja e ndihmave horizontale në Shqipëri

Ndihma Horizontale	2007		2008		2009		Total	
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		121,78		122,80		132,10		
Punësimi	77,60	0,64	80,20	0,65	72,43	0,55	230,23	1,84
Kultura	121,07	0,99	-	-	-	-	121,07	0,99
Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksporti	-	-	0,42	0,0035	0,150	0,0011	0,57	0,00
Ndihma shtetërore operacionale	66,74	0,55	2.989,72	24,35	2.477,51	18,75	5.533,97	43,65
Shpëtim dhe Ristrukturim	-	-	-	-	-	-	-	-
Kërkim dhe Zhvillim	1.126,14	9,25	2.078,65	16,93	1.645,90	12,46	4.850,69	38,63
SME-të	2,40	0,02	12,80	0,10	21,00	0,16	36,20	0,28
Sporti	48,61	0,40			-	-	48,61	0,40
Trajnimi	39,60	0,33	131,00	1,07	116,91	0,88	287,51	2,28
Ndihma sociale për konsumatorë individualë	2.000,00	16,42	-	-	-	-	2.000,00	16,42
Total	3.482,15	28,59	5.292,80	43,10	4.333,89	32,81	13.108,84	104,50

Siç shihet edhe në grafikun 3, peshat e ndihmës horizontale, duke krahasuar me vitin 2008 kanë ruajtur të njëjtën strukturë. Gjatë vitit 2009 ndihma horizontale, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin, përfaqëson 62.19 % të ndihmës shtetërore të dhënë dhe nëse përjashtojmë bujqësinë dhe peshkimin, 73.09 % të totalit të ndihmës shtetërore në vend.

Grafiku 3 Peshat e ndihmës horizontale për vitet 2008-2009



Në ndihmën horizontale përfshihet ndihma për tregun e punës²², SME-të²³, trajnim²⁴, dhe ndihma operacionale, si dhe ndihma për kërkim zhvillim që zënë peshën më të madhe në këtë kategori.

Ndihma operacionale përfshin skemën e shtyrjes së TVSH-së për importin e makinerive dhe pajisjeve²⁵, skemën e rimbursimit të akcizës për lëndët djegëse për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW²⁶, skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje²⁷, si dhe skemën ekzistuese të dhënies me qira të pronave shtetërore. Kjo kategori ka pësuar një rënie nga 2,989.72 milionë lekë në vitin 2008 në 2,477.51 milionë lekë për vitin 2009.

Ndërsa në ndihmën për kërkim zhvillim përfshihet skema ekzistuese e përjashtimit nga detyrimet doganore dhe TVSH e operacioneve hidrokarbure²⁸.

²² Vendim i KNSH-së nr. 9, datë 2. 02. 2007 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit”;

Vendim i KNSH-së nr. 13, datë 15.03.2007 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional”;

Vendim i KNSH-së nr. 11, datë 15. 03. 2007 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë”;

Vendim i KNSH-së nr.14, datë 15.03.2007 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra”.

²³ Vendim i KNSH-së nr. 10, datë 2.02.2007 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin “Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë””.

²⁴ Vendim i KNSH-së nr.12, datë 15.03.2007 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.


²⁵ Vendim i KNSH-së nr. 17, datë 16.07.2007 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”.

²⁶ Vendim i KNSH-së nr. 25, datë 2.05.2008 “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5 MW”, i ndryshuar me vendimin e KNSH-së nr. 27, datë 18.08.2008.

²⁷ Vendim i KNSH-së nr. 24, datë 2.05.2008 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”.

²⁸ Vendim i KNSH-së nr. 22, datë 12.12.2007 “Për përjashtimin e operacioneve hidrokarbure nga detyrimet doganore dhe TVSH”.

Grafiku 4 Ndhimat horizontale për vitet 2007-2009



Pjesa që zë ndihma horizontale në raport me totalin e ndihmës shtetërore në vend, (duke përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin), për vitet 2007 dhe 2008, krahasuar me mesataren e këtyre kategorive në BE dhe në secilin prej shteteve anëtare, paraqitet në tabelën 10.

Tabela 10 Ndihma shtetërore horizontale në Shqipëri krahasuar me mesataren e BE-së (%)

Emri i shtetit/ Viti	Shqipëria	EU-totali	EU-15	EU-12	Belgjika	Bullgaria	Çekia	Danimarka	Gjermania	Estonia	Irlanda	Greqia	Spanja	Franca	Italia	Qipro	Letoni	Lituani	Luksemburg	Hungaria	Malta	Hollanda	Austria	Polonia	Portugalia	Rumania	Slovenia	Slovakia	Finlanda	Suedia	Anglia
2007	22	80	80	77	100	92	100	92	79	100	77	98	74	95	89	95	100	96	100	53	4	96	98	89	10	36	84	76	96	99	62
2008	43	88	88	87	99	91	94	94	87	100	84	98	79	96	85	95	100	100	100	81	2	98	99	93	16	53	89	84	98	100	91

3.5 NDIHMA SEKTORIALE/VERTIKALE NË SHQIPËRI

Në vlerë, ndihma sektoriale llogaritet në masën 1,595.74 milionë lekë (ose 12.08 milionë €). Gjatë vitit 2009 ndihma sektoriale në Shqipëri, duke përfshirë bujqësinë dhe peshkimin, përfaqëson 22.9 për qind të totalit të ndihmës shtetërore të dhënë dhe nëse përfshijmë bujqësinë dhe peshkimin, 26.91 % të totalit të ndihmës shtetërore në vend.

Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2009, peshën më të lartë e zë ndihma për shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve) me 55 për qind, duke u ndjekur nga ndihma për transportin publik me 32 për qind, nga ndihma për sektorin e energjisë me 10 për qind dhe ndihma për minierat me 3 për qind.

Tabela 11 Shpërndarja e ndihmës sektoriale në Shqipëri


Ndihma sektoriale (vertikale)	2007		2008		2009		Total	
	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR	In mil LEK	In mil EUR
<i>kursi mesatar i këmbimit</i>		121,78		122,80		132,10		
Transporti publik	734,50	6,03	737,77	6,01	513,71	3,89	1.985,98	15,93
Shërbime publike	1.619,13	13,30	1.454,38	11,84	878,00	6,65	3.951,51	31,79
Minerat	-	-	56,92	0,46	43,27	0,33	100,19	0,79
Energjia	3.732,82	30,65	4.118,01	33,53	157,86	1,20	8.008,69	65,38
Audio	-	-	-	-	-	-	-	-
Televizionet/mediat	2,86	0,02	2,89	0,02	2,89	0,02	8,64	0,07
Tourismi	18,90	0,16	-	-	-	-	18,90	0,16
TOTAL	6.108,21	50,16	6.369,97	51,87	1.595,74	12,08	14.073,92	114,11

Në vitin 2009 ndihma për shërbimet publike është dhënë në masën 878 milionë lekë, një subvencionim nga Buxheti i Shtetit si mbështetje e qeverisë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, me qëllim mbulimin e një pjese të kostove operacionale²⁹ për ndërmarrjet me kapital shtetëror.

Për sa i takon transportit publik ndihma shtetërore është dhënë nga Buxheti i Shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor ka pësuar një rënie në kohë³⁰. Mbështetja e shtetit për minierat ka pasur gjithashtu një rënie të dukshme gjatë viteve 2008-2009, ndërkohë që pjesa më e vogël e ndihmës sektoriale në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe, lidhet me sektorin e transmetimit/mediatik.

Peshat e ndihmës sektoriale duke u krahasuar me vitin 2008 kanë pësuar ndryshime të dukshme, në vitin 2009 ndihma për shërbimet publike zë peshën më të madhe në totalin e ndihmës me 55 për qind, e pasuar me transportin publik (32 %) dhe sektorin e energjisë me 10 %. Në vitin 2008, ndihma për sektorin e energjisë përbën pjesën më të madhe të totalit të ndihmës me rreth 65 për qind e ndjekur me shërbimet publike (23 %) dhe transportin publik me rreth 12 për qind.

Grafiku 5 Peshat e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitet 2008-2009




²⁹ Vendim KNSH-së nr. 5, datë 20.10.2006 "Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit".

³⁰ Vendim i KNSH-së nr. 8, datë 2.02.2007 "Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave".

Duke pasur parasysh se në ndihmën për energjinë përfshihet shtyrja e pagesës së TVSH-së për importimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.³¹, si edhe financimi nga Buxheti i Shtetit për investime (Programi “Mbështetje për energjinë”), në vitin 2009 ndihma për këtë sektor ka pësuar një ulje të madhe, si pasojë e rënies së sasisë së energjisë elektrike të importuar.

Mbështetur në të dhënat e INSTAT³², në vitin 2009 importi i energjisë elektrike shënoi një ulje prej 97.9 për qind krahasuar me vitin 2008, dhe si pasojë e kushteve meteorologjike, në vitin 2009 burimi i vetëm i prodhimit të energjisë elektrike ishte prodhimi në hidrocentrale (rritur me 35.7 për qind krahasuar me vitin 2008) duke dhënë ndikimin kryesor në rritjen e prodhimit total të energjisë dhe uljen e sasisë energjisë të importuar.

Grafiku 6 Ndihmat sektoriale për vitet 2007-2009



KAPITULLI 4 KONKLUSIONE

Raporti për ndihmat shtetërore për vitin 2009, i paraqitur nga Republika e Shqipërisë për BE-në dhe CEFTA-n, vjen si një zbatim i detyrimeve të sanksionuara në MSA dhe në marrëveshjen e CEFTA-s 2006, për sigurimin e transparencës ndërkombëtare. Në këtë raport janë përshirë të gjitha skemat ekzistuese apo planet e reja të ndihmës shtetërore, për të cilat Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka dhënë vendimet përkatëse.

Ndihma totale për vitin 2009 është në vlerën 6.968,46 milionë lekë. Kjo vlerë e ndihmës është 56 % më pak në krahasim me vitin 2007. Në të njëjtën kohë, ndihma shtetërore për vitin 2009 kundrejt PBB është 0.61 për qind, një rënie në krahasim me 2008, kur llogariten në 1.16 për qind.

Instrumentet kryesore të përdorura për dhënien e ndihmës shtetërore për periudhën e trajtuar në këtë raport, kanë qenë grantet, përjashtimi dhe ulja e taksave. Instrumenti që zë peshë më të madhe në vitin 2009 është A2- (përjashtimet, shtyrja, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale) me 72.2 për qind, ndjekur nga A1- (subvencionet dhe grantet) me 27.75 për qind, ndërsa C2-instrumente të tjera dhe D (garancitë), kanë qenë përkatësisht në 0.05 për qind dhe 0.0025 për qind.

³¹ Vendim i KNSH-së nr.17, datë 16.07.2007 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”.

³² INSTAT: Bilanci i Energjisë Elektrike Publikim i 31.03.2010

Në vitin 2009, ndihma horizontale përfaqëson 62 për qind, ndërsa ndihma sektoriale 23 për qind të totalit të ndihmës shtetërore në vend, duke përfshirë bujqësinë, peshkimin dhe transportin.

Ndihmat horizontale për vitin 2009, kanë pasur një trend në ulje me 958.31 milionë lekë kundrejt vitit 2008, kjo ka ardhur si pasojë e një uljeje të ndihmave për kategoritë, si: punësimi, kërkim dhe zhvillimi, operacionale, garancitë për eksport dhe trajnim. Gjithashtu ndihmat sektoriale (vertikale) kanë pasur një trend në ulje me 4,774.23 lekë . Për vitin 2009, peshën më të lartë në kategorinë e ndihmave sektoriale, e zë ndihma për shërbimet publike me 55 për qind, duke u ndjekur nga ndihma për transportin publik me 32 për qind, nga ndihma për sektorin e energjisë me 10 për qind dhe ndihma për sektorin e minierave me 3 për qind.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe është plotësuar kuadri ligjor ekzistues për ndihmën shtetërore, në kuadër të procesit të integritimit dhe detyrimeve për përafrimin e legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, me miratimin e ligjit nr. 10 183, datë 29.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore"". Ndryshimet dhe shtesat që i janë bërë këtij ligji, reflektojnë ndryshimet përkatëse në legjislacionin europian për fushën e ndihmës shtetërore, si rezultat i reformës ligjore të ndërmarrë gjatë viteve 2005-2008.

Mesatarja e raportit ndihmë shtetërore ndaj PBB-së për vendet e BE-së (pa bujqësinë, peshkimin dhe transportin) është në vlerat 0,4 % për vitet 2007 dhe 2008, ndërkohë që për Shqipërinë ky tregues nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme (nga 0.92 për vitin 2007 në 1.01 për vitin 2008).

Për periudhën 2007-2008, ndihma horizontale për 27 vendet e EU-së ka pësuar një rritje me 13 për qind, për Shqipërinë rritja vlerësohet të jetë me 52 për qind. Gjithashtu, treguesi i ndihmës shtetërore kundrejt PBB-së në Shqipëri, ka pësuar rënie në vlerën e saj. Për vitin 2009, në sajë të politikave mbështetëse të qeverisë, vërehet tendenca e orientimit të ndihmave nga ato sektoriale drejt atyre horizontaleve duke u harmonizuar me parimin e dhënies më pak ndihmë për një përdorim efektiv saj, sikurse është shpallur edhe në “Planin e veprimit për ndihmën shtetërore” të Komisionit Europian për periudhën 2005-2009.

VENDIM

Nr.9, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR VOSKOPI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Rafael Marko, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Voskopi”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunat Voskop dhe Mollaj.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Endira Bushati**

5899

VENDIM
Nr.10, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR KRUTJA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Fatjon Latifi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Krutja”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunat Krutje, Këmishtaj, Fier-Shegan, Gradishtë, Rremas, Allkaj.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.11, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR CAKRANI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Rustem Xhelaj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Cakrani”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Cakran.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.12, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR VJOSA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Shezai Aliaj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Vjosa”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Novoselë.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.13, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR BELSHI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Gazmend Doçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Belshi”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal bashkinë Belsh.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.14, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR BRADSAT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Arben Xhina, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Bradsat”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Bradashesh.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.15, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR TOSHKËZ”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Riza Jaho, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Toshkëz”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Allkaj.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.16, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR PROGRES TV”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Fatos Senko, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “Progres TV”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin Kavajë dhe komunën Synej.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.17, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR M&G”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.856, datë 15.5.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë subjektit fizik z.Gentian Biquku, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV M&G”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunat Papër dhe Cërrik.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.18, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR DCT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.875, datë 30.7.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë z.Ervid Linkollari, person fizik, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor DCT”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal bashkinë Poliçan dhe komunën Ksamil.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.19, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR PUPA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 123 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr. 875, datë 30.7.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë z.Eneritan Pupa, person fizik, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor PUPA”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal fshatrat Xengë-Mizë-Zharrnecë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.20, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV VLORA CABLE”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr. 875, datë 30.7.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë z.Sandrit Danaj, person fizik, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Vlora Cable”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin Vlorë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.21, datë 28.7.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR XHAÇI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr. 875, datë 30.7.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë z.Dritan Xhaçi, person fizik, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV kabllor Xhaçi”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Miras.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.23, datë 28.7.2010

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT
KABLLOR “TV KABLLOR FOKUS”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.875, datë 30.7.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “TV kabllor Fokus” me nr.licence 033/RTVK, për në komunën Libonik.
 2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
 3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Licencave, Drejtoria Teknike, Drejtoria Ekonomike për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.24, datë 28.7.2010

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE
“RADIO AUTOSTRADA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor” dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht, sipas vendimit nr.882, datë 28.9.2009 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë si operator radiofonik privat vendor shoqërinë “Radio Autostrada” sh.p.k., pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se nga ana e subjektit nuk janë paraqitur struktura organizative, organigrama dhe përmbajtja e disa programeve që do të transmetohen.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga marrja në dijeni, në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.25, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“VAL E KALTËR”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Val’ e Kaltër”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.26, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“TOP GOLD”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Top Gold”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.27, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“EUROSTAR”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Eurostar”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 23.9.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.28, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“FIERI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Fieri”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.29, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“CLUB FM”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Club FM”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.30, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
RADIO “RASH”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Rash”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.31, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV KUKËSI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “TV Kukësi”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.32, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
RADIO “ENERGY”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Energy”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 16.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.33, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV SCAN”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “TV Scan”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.34, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
RADIO “KONTAKT”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Kontakt”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 16.1.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.35, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“NESËR TV”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “Nesër TV”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

VENDIM
Nr.36, datë 28.7.2010

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR RADIO
“NACIONAL”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Nacional”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 6.2.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Endira Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 31.8.2010

Doli nga shtypi më 1.9.2010

Tirazhi: 2300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë